



1354
29-12-2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 6418/1 Prot

Elbasan më 29 /12/2025

VENDIM

Nr 151 datë 29 /12/2025.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin NENTOR 2025

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 23 datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin NENTOR 2025, 97 familje me fond 282.000 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr Shërbimeve Sociale
Drejtori Juridik

D.Shuli
A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Miratuar datë 29.12.2025

Pro 34

Kundër 0

Abstenim 2

6418/2
28.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 1354/1 Prot

Elbasan, më 28/12.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.151, datë 24.12.2025 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Nëntor 2025”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir Bejtja

1353

29.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 6419/1 ProtElbasan më 23 /12/ 2025**VENDIM**Nr. 152 datë 24 /12/2025**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin NENTOR 2025**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 24 datë 04.03.2025 "Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike"

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **NENTOR 2025** gjithsej 261 familje me një fond prej 1.219.032 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtori Shërbimit Social D.Shuli
Drejtori Juridik A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala

Miratuar datë 24 /12/2025Pro 34Kundër 0Abstenim 3

6418/2

28.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 1353/1 Prot

Elbasan, më 28.12.2025


Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.152, datë 24.12.2025 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Nëntor 2025”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI
Ilir Bejtja



REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 6600 Prot

Elbasan më, 28.12.2025

VENDIM

Nr. 153, datë 24.12.2025

Mbi emërimin e Sekretarit të Këshillit Bashkiak Elbasan

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës __.__.2025, nisur nga krijimi i vakancës së pozicionit të Sekretarit të Këshillit bashkiak, me propozim të Kryetarit të Këshillit, bazuar në Rregulloren e Këshillit Bashkiak Elbasan Neni 17, Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 57 dhe Neni 54 pika c:

VENDOSI:

1. Të miratojë emërimin e Z. Elsid Zyma në pozicionin e Sekretarit të Këshillit Bashkiak Elbasan.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Këshilli Bashkiak Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Lutfi Lala



6600/1
05.01.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1370/1 Prot.

Elbasan më 5.1. 2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.153 datë 24.12.2025 “Mbi emërimin e Sekretarit të Këshillit Bashkiak Elbasan” konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir BEJTJA



1373
28.12.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6434/1 prot.

Elbasan më 28.12.2025

VENDIM

Nr. 156 Datë: 24.12.2025

“Miratim për marrje me qira dhe rinovim kontratash të mjediseve për t’u përdorur për shkolla dhe kopshte në disa Njësi Administrative të Bashkisë Elbasan”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ .12.2025, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës “Miratim për marrje me qira të mjediseve për t’u përdorur për shkolla/kopshte për disa Njësi Administrative të Bashkisë Elbasan”, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 69/2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.” me qëllim plotësimin e nevojave të institucioneve të arsimit parauniversitar me ambiente, sipas kërkesave të Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare Elbasan nr.1579prot. datë 19.11.2025 “Dërgohen kërkesa për ambiente me qira” dhe nr.1606/1prot. datë 03.12.2025,

VENDOSI:

2. Të miratojë marrjen me qira të mjediseve për t’u përdorur për shkolla/kopshte si paraqiten në vijim:

Nr	Njesia Administrative	Subjekti qiramarrës	Qellimi qiramarrjes	Vendndodhja	Klasa nr	Sipërfaqja m ²	Vlera kontrates Lekë/muaj	Subjekti qiradhenes	Mjedis ekzistues / Mjedis i ri
1	Shushicë	Shkolla Shushicë	Shkolle	Shushicë	2	100 m ²	20.000	Fatmir Murati	Mjedis i ri
2	Shushicë	Shkolla Shushicë	Kopsht	Shushicë	4	100 m ²	40.000	Fatmir Murati	Mjedis i ri
3	Gracen	Shkolla Gjorme	Shkolle	Gjorme	1	30 m ²	3.000	Ndricim Dokoli	Mjedis i ri
4	Gracen	Shkolla Gjorme	Shkolle	Gjorme	1	50 m ²	5.000	Ndricim Dokoli	Mjedis ekzistues
5	Gracen	Shkolla Gjorme	Shkolle	Terbac	2	30 m ²	6.000	Resmi Stafa	Mjedis ekzistues
6	Gracen	Shkolla Gjorme	Kopsht	Terbac	1	30 m ²	3.000	Resmi Stafa	Mjedis ekzistues
7	Tregan	Shkolla Shilbater	Kopsht	Cikallesh	1	50 m ²	5.200	Feride Tashi	Mjedis ekzistues
8	Labinot Fushe	Shkolla Sulejman Rranci	Kopsht	Mengel	1	70 m ²	7.000	Xhevit Shabani	Mjedis ekzistues
9	Elbasan	Kopshti Nr 4	Kopsht	Rajoni Nr 6	1	90 m ²	15.000	Denis Dyrmishi	Mjedis ekzistues

2. Afati i kontratave është 01.09.2025 – 31.08.2026

3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Arsimit, Shëndetësisë, Rinisë, Sportit, Migracionit dhe Diasporës, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Drejtoria e DASHRSMD
Drejtoria e DPKSARS
Drejtoria e B.F
Drejtoria Juridike
Zv/Kryetari

K.Lala
D.Rroseni
A. Merkja
A.Hoxha
A.Shehu

KRYETARI

Lutfi Lala



6434/2
05.01.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1373 Prot.

Elbasan më 5.1. 2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj Nr.156, datë 24.12.2025 “Miratim për marrje me qira dhe rinovim kontratash të mjediseve për tu përdorur për shkolla dhe kopshte në disa Njësi Administrative të Bashkisë Elbasan”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN PROJEKTEVE DHE DONATORËVE

Nr. 6387 / 11 prot

Elbasan me 8. 12. 2025

KËSHILLIT BASHKIAK
ELBASAN

VENDIM

Nr. 158, datë 24/ 12/2025

Mbi miratimin në parim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me nr. 6710 prot datë 02/12/2025 ndërmjet Bashkisë Krushevë (lider) dhe partner: Bashkinë Elbasan, Tjetër Vizionin dhe Alka, Programi IPA, Programi Ndërkufitar Republika e Maqedonisë së Veriut - Republika e Shqipërisë, Instrumenti i Asistencës së Para-Aderimit (IPA II)

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____/____/2025, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

VENDOSI

1. Mbi miratimin në parim të “Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Krushevë (lider) dhe partner: Bashkinë Elbasan, Tjetër Vizionin dhe Alka, Programi IPA, Programi Ndërkufitar Republika e Maqedonisë së Veriut - Republika e Shqipërisë, Instrumenti i Asistencës së Para-Aderimit (IPA II);
2. Ngarkohen për zbatim drejtoritë e Bashkisë Elbasan: Drejtoria e Planifikimit të Përgjithshëm dhe të Detajuar Urban, Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Ekonomik dhe Transportit, Drejtoria e Politikave të Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore, Drejtoria e Integrimit Evropian Projekteve Strategjike Inovacionit, Drejtoria e Buxhet-Financës, Drejtoria e Investimeve dhe Prokurimeve, dhe Drejtoria Juridike dhe Informacionit;
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak;

Konceptoi: P.S.P.D
Pranoi: Dr. DIEPSI
D.D.B.F
D.J.I

K.Kreka
E.Cuni
A.Merkja
A.Hoxha

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi LALA

6387/2

08.01.2026



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK**

Nr. 1375/1 Prot.

Elbasan më 08/01. 2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.158, datë 24.12.2025 “Mbi miratimin në parim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me nr.6710, prot datë 02/12/2025 ndërmjet Bashkisë Krushevë (lider) dhe partner: Bashkinë Elbasan, Tjetër Vizionin dhe Alka, Programi IPA, Programi Ndërkufitar Republika e Maqedonisë së Veriut – Republika e Shqipërisë, Instrumenti i Asistencës së Para-Aderimit (IPA II)”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir BEJTJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 64171 Prot.

Elbasan, më 28.12 2025

VENDIM

Nr. 158 datë 24/12/2025

"Mbi rilidhjen e kontratave një-vjecare te qirasë"

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___/___/2025, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Aseteve, Pronave dhe Strehimit (Sektori i Strehimit), mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin nr.9232 datë 13/5/2004 "Për programet sociale të strehimit" (i ndryshuar);
- VKM nr.574 datë 29/8/2012 "Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërës prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore";
- Manualin e Menaxhimit të Banesave Sociale me Qira;
- Kontratat e qirasë lidhur ndërmjet Bashkisë Elbasan dhe 96 familjeve përfituese të BSQ-ve me VKB nr.79 datë 27/9/2012 (ndryshuar me VKB nr.24 datë 24/4/2013), VKB nr.84 datë 26/10/2012 dhe VKB nr.06 datë 25/01/2013;

VENDOSI:

- Të rilidhen kontratat e qirasë me 50 familjet përfituese, sipas listës bashkëlidhur.
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Strehimit dhe Njësia e Menaxhimit të Banesave Sociale me Qira.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
-

Pergjegjesi i Banesave Sociale: F.Musaj

Drejtore i Pergjithshem : D.Shuli

Drejtore Drejtorie Pronave Publike dhe Strehimit: G.Dyrmyshe

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Miratuar datë:

Pro:

Kundër:

Abstenim :

6417/2

07.01.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1376/1 Prot.

Elbasan më 7.1.2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.159 datë 24.12.2025 “Mbi rilidhjen e kontratave njëvjeçare të qirasë” konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





1377
28.12.2025
SEKRETARIA
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
Këshilli Bashkiak

Nr. 6387/1 Prot.

Elbasan, më 28 . 12 . 2025

VENDIM
Nr 160 Datë 24 / 12 / 2025
Për miratimin e kontratës së dhurimit

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ____ / ____ / 2025, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit, si dhe draftin e kontratës së dhurimit, bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" nenet, 8, 9, 23, 54 të tij,

Vendosi

- 1- Të miratojë kontratën e dhurimit të një makine tip Ford Fiesta me numër shasie WF0DXXGAKDGB09163 me targë AA946NJ, nga Raffeisen Bank sh.a., sipas tekstit bashkëngjitur, makinë e cila do të kalojë në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Kulturës dhe Sportit
- 2- Ngarkohen Kryetari dhe administrata e Bashkisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit me zbatimin e këtij vendimi
- 3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

Spec/Jurist : E.Koka

Pergj Sek Juridik Administrativ : L.Saliu

Dr. Administrates : E.Zyma

Dr. Pergjithshem : A.Kovaçi

Dr. J.I. A. Hoxha

Kryetari
Lutfi Iala



6397/2

05.01.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1377/1 Prot.

Elbasan më 05.01. 2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.160 datë 24.12.2025 “Për miratimin e kontratës së dhurimit” konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir BEJTJA



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 644/1 prot.

Elbasan më 29.12.2025

VENDIM

Nr. 161 datë 24.12.2025

“Për miratimin e dhënies me qira te ambjenteve në godinën e pallatit të sportit “Tomorr Sinani”, në lagjen “28 Nëntori”, nga Bashkia Elbasan”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës __. __. __, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Klubi Shumësportesh i Bashkisë Elbasan “Për miratimin e dhënies me qira te ambjenteve në godinën e pallatit të sportit “Tomorr Sinani”, në lagjen “28 Nëntori”, nga Bashkia Elbasan” mbështetur në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar);
- VKM nr.416 date 11.07.2007 “Per miratimin e listes perfundimtare te pronave te paluajshme te shtetit, qe tranferohen ne pronesi ose ne perdorim, te Bashkise Elbasan” (i ndryshuar);
- VKM nr. 54 date 05.02.2014 “Per percaktimin e kriterëve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurive shteterore” (i ndryshuar);
- VKB nr. 48 datë 30.5.2025 “Për miratimin e dhënies me qira te ambjenteve në godinën e pallatit të sportit “Tomorr Sinani”

VENDOSI:

- Të miratojë dhënien me qira te ambjenteve në godinën e pallatit të sportit “Tomorr Sinani”, në lagjen “28 Nëntori”, subjekteve private si mëposhte vijon:

- Z. Engjell Spahiu**, i jepet me qira ambjenti “dhomë” (bar-kafe), në godinën e Pallatit të Sportit, kati përdhes, hyrja juglindore e godinës, me sipërfaqe 34.41 m², me tarifë mujore qiraje 600 lekë/m², me afat 1 vjeçar, nga 01.01.2026 – 31.12.2026, sipas planvendosjes bashkangjitur.
- Z. Engjell Spahiu**, i jepet me qira ambjenti “dhomë” (bar-kafe), në godinën e Pallatit të Sportit, kati përdhes, hyrja juglindore e godinës, me sipërfaqe afersisht 30 m², me tarifë mujore qiraje 600 lekë/m², me afat 1 vjeçar, nga 01.01.2026 – 31.12.2026, sipas planvendosjes bashkangjitur.
- Znj. Vetiana Gica**, i jepet me qira ambjenti “dhomë” (bar-kafe), në godinën e Pallatit të Sportit, kati përdhes, hyrja lindore e godinës, me sipërfaqe 56.7m², me tarifë mujore qiraje

600 lekë/m², me afat 1 vjeçar, nga 01.01.2026 – 31.12.2026, sipas planvendosjes bashkangjitur.

- Znj. **Vetiana Gica**, i jepet me qira ambjenti “dhomë” (bar-kafe), në godinën e Pallatit të Sportit, kati përdhes, hyrja lindore e godinës, me sipërfaqe 32.4 m², me tarifë mujore qiraje 600 lekë/m², me afat 1 vjeçar, nga 01.01.2026 – 31.12.2026, sipas planvendosjes bashkangjitur.
- Z. **Jorgji Biqiku**, i jepet me qira ambjenti “dhomë” (riparime elektrike dhe elektronike), në godinën e Pallatit të Sportit, kati përdhes, hyrja perëndimore e godinës, me sipërfaqe 19 m², me tarifë mujore qiraje 300 lekë/m², me afat 1 vjeçar, nga 01.01.2026 – 31.12.2026, sipas planvendosjes bashkangjitur.
- **Era Travel**, i jepet me qira ambjenti “dhomë” (Holl pasagjeresh), në godinën e Pallatit të Sportit, kati përdhes, hyrja veriore e godinës, me sipërfaqe 20 m², me tarifë mujore qiraje 300 lekë/m², me afat 1 vjeçar, nga 01.01.2026– 31.12.2026, sipas planvendosjes bashkangjitur.

2. Ngarkohen Klubi Shumësportesh Bashkia Elbasan dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI



Konceptoi:

Spc.Jurist:D.P.K.S E. Koka

Pranoi:

Dr.Administrate; D.P.K.S E. Zyma

Miratoi:

Dr.Pgj:D.P.K.S; A. Kovaçi

Dr. Buxhet –Finance; A.Merkja

Konfirmoi:

Drejtori i Drejt. Prgjthsh. Ardh. Buxh. e Fin; G. Dyrmyshi

Zv/Kryetar; Armand Shehu

6414/2

05.01.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1372/ Prot.

Elbasan më 05.1.2026

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj Nr.161, datë 24.12.2025 "Për miratimin e dhënies me qira të ambienteve në godinën e pallatit të sportit "Tomorr Sinani", në lagjen "28 Nëntori", Bashkia Elbasan", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir BEJTJA